



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI
KOMISIONERI**

Nr. 1260/5 Prot.

Tiranë, më 03 . 08 . 2026

V E N D I M

Nr. 209 , datë 03 . 08 . 2026

Bazuar në Ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është regjistruar ankesa nr. 167, datë 08.07.2026, e paraqitur nga z. O.V kundër Shkollës së Magjistraturës, me pretendimin për diskriminim për “çdo shkak tjetër”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Bazuar në provat shkresore të depozituara, rezulton i provuar fakti se, pala ankuese O.V, në cilësinë e kandidatit për magistrat, profili gjyqtar, me datë 30.06.2024 dhe 01.07.2024 i është nënshtruar provimit përfundimtar të vitit të II-të, të zhvilluar nga Shkolla e Magjistraturës.

Rezulton i provuar fakti se, me datë 30 Qershor dhe me datë 01 Korrik 2024, pala ankuese si të gjithë kandidatët e tjerë të provimit përfundimtar të vitit të dytë të zhvilluar në 4 lëndët kryesore, konkretisht në lëndën “E drejtë Civile”, “E drejtë Penale”, “E drejtë Administrative” dhe “E drejtë Kushtetuese”, ka firmosur deklaratën me përmbajtjen, si më poshtë vijon: “Unë i nënshkruari z. O.V, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se në momentin e fillimit të provimit, angazhohem solemnisht dhe në nderin tim që nuk do të komunikoj me persona të tretë, apo burime të jashtme. Çdo gjë që do shkruaj është rezultat i njohurive dhe aftësive të mia personale. Jam i vetëdijshëm që shkëlja e këtij angazhimi përbën një rast mashtrimi i sanksionuar në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës dhe është i mjaftueshëm për të më përjashtuar nga zhvillimi i provimit. Deklarues O.V, nënshkrimi me datë 30.06.2024 dhe me datë 01.07.2024”.

2. Rezulton i provuar fakti se, me datë 18.07.2024, janë shpallur rezultatet e provimit përfundimtar të vitit të dytë, për kandidatët për magistratë, për 4 fushat kryesore, ku pala ankuese O.V, nga 100 pikë, ka marrë rreth 81.5 pikë në total, referuar shkresës “kthim-përgjigje”, me Nr. 387/1, datë

27.03.2025, dërguar nga Shkolla e Magjistraturës, ku bashkëlidhur gjendet kopje e noterizuar e procesverbalit të nënshkruar nga Anëtarët e Komisionit të Provimit Përfundimtar mbi “Rezultatet e provimit përfundimtar të vitit të dytë në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar (ku bën pjesë edhe pala ankuese O.V) dhe prokuror 2023-2024”.

3. Rezulton i provuar fakti se, nëpërmjet vendimit me nr. 5, datë 26.07.2024 “Për vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë për vitin akademik 2023-2024”, Këshilli Pedagogjik, Shkolla e Magjistraturës ka miratuar vlerësimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të parë të programit të Formimit Fillestar, mbi bazën e rezultateve të arritura gjatë periudhës dyvjeçare të vitit teorik dhe stazhit paraprofesional/etikës profesionale, përfshirë edhe palën ankuese O.V. Bashkëlidhur vendimit pasqyrohet Raporti “Për klasifikimin përfundimtar të kandidatëve për magjistratë të vitit të dytë për vitin akademik 2023-2024”, ku pala ankuese O.V rezulton renditur në vend e 17 nga 46 kandidatët për magjistratë, profili gjyqtar, duke ruajtur të njëjtin pozicion renditje sikurse në vitin e parë 2022-2023.

4. Në vijim ky raport është miratuar edhe nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës, ku anëtar është edhe Drejtori i Shkollës së Magjistraturës, si dhe z. V.K (Prokurori i Disiplinës), ku pas certifikimit të rezultatit përfundimtar të renditjes së kandidatëve për magjistratë të vitit të II, përfshirë edhe palën ankuese, rezulton se vendimi i është dërguar Këshillit të Lartë Gjyqësor për përcaktimin e gjyqtarëve udhëheqës të kandidatëve për magjistratë për vijimin e praktikës profesionale të vitit të III.

5. Rezulton i provuar fakti se, mbi bazë të akteve të dërguara me datë 31.07.2024 nga Këshilli Drejtues i Shkollës së Magjistraturës. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka nxjerrë vendimin me Nr. 485, datë 28.08.2024 “Për caktimin e gjykatave dhe gjyqtarëve udhëheqës gjatë praktikës profesionale të kandidatëve për magjistratë të Shkollës së Magjistraturës për vitin akademik 2024-2025”, bashkëlidhur lista e gjyqtarëve udhëheqës të caktuar për çdo kandidat për magjistrat për vitin akademik 2024-2025 (përfshirë palën ankuese O.V), i cili që prej datës 1 Korrik 2024 për efekt të ligjit (neni 33, pika 1 e Ligjit Nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në parashikimet e vendimit Nr. 485, datë 28.08.2024 i Këshillit të Lartë Gjyqësor), ka vazhduar praktikën profesionale pranë Gjykatës së Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, në cilësinë e kandidatit për magjistrat viti III, profili gjyqtar.

6. Rezulton i provuar fakti se, me datë 31.07.2024 (30 ditë pas zhvillimit të provimit përfundimtar), pala ankuese është informuar në lidhje me vendimin e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, për fillimin e procedimit disiplinor ndaj kandidatit për magjistrat O.V, si dhe kërkesën e Drejtorit të Shkollës së Magjistraturës, drejtuar Komisionit Disiplinor për marrjen e masës së përjashtimit nga Shkolla të kandidatit për magjistrat, profili gjyqtar O.V, me pretendimin për shkelje të rregullave të provimit përfundimtar “pavarësisht ardhjes apo jo të pasojës”.

7. Nëpërmjet vendimit Nr. 5, datë 16.09.2024, Komisioni i Disiplinës i Shkollës së Magjistraturës, ka vendosur: “Marrjen e masës disiplinore përjashtim nga shkolla e kandidatit për magjistrat O.V”. Akti administrativ është kundërshtuar brenda afatit ligjor, përpara Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe çështja aktualisht ndodhet në proces gjykimi.

Ankuesi pretendon trajtim të diferencuar në krahasim me 51 kandidatë të tjerë të ndodhur në të njëjtat kushte faktike/ligjore:

- Ndaj ankuesit u zbatua masa më ekstreme (përjashtim nga Shkolla), ndërsa ndaj 51 kandidatëve të tjerë të konstatuar në shkelje, përfshirë vetë anëtarin e Komisionit të Disiplinës, D.K nuk u ndërmor asnjë masë disiplinore dhe rasti u “amnistua”.
- Drejtori i Shkollës referoi rastin e ankuesit te Prokurori i Disiplinës për verifikime paraprake, por nuk bëri të njëjtën gjë për 51 kandidatët e tjerë, pavarësisht provave (raporti 216-faqesh + publikimet e “Fiks Fare”).
- Krahasim me precedentin e kandidatit A.K. (KLGJ, vendim nr. 84/2023), ku për shkelje të ngjashme etike u aplikua masa më e lehtë “vërejtje”.
- Standarde të dyfishta edhe në aspekte të tjera: 29 kompjuterë pa monitorim me programin “OBS”; kandidatë të vendosur në grupe/salla të njëjta në kundërshtim me rregullat e shpërndarjes; provimi i vitit I u anulua për probleme më të vogla (wireless), ndërsa provimi i vitit II me shkelje flagrante u mbajt i vlefshëm”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga Shkolla e Magjistraturës në trajtimin disiplinor të ankuesit, në krahasim me 51 kandidatët e tjerë dhe marrjen e masave administrative ndaj subjekteve përgjegjëse pranë Shkollës së Magjistraturës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës

Në kuadër të shqyrtimit paraprak, Komisioneri konstatoi se në formularin e ankesës, ankuesi ka informuar se pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë është regjistruar çështja administrative me palë ndërgjyqëse: “Paditës: O.V; Palë e Paditur: Shkolla e Magjistraturës; Palë e Tretë: Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Avokatura e Shtetit; Objekti i Padisë: “Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga institucioni publik, Shkolla e Magjistraturës, në trajtimin disiplinor të palës ankuese O.V, në cilësinë e kandidatit për magjistrat viti II, duke realizuar trajtim të diferencuar të kandidatëve për magjistratë, krahasuar me 51 kandidatë të tjerë, të ndodhur në kushte të njëjta faktike dhe ligjore, të cilët janë konstatuar në shkelje të rregullave të provimit përfundimtar të vitit të dytë, të zhvilluar me datë 30 Qershor dhe 1 Korrik 2024”. Rezulton se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në seancë përgatitore, me vendimin Nr. 11103/6205 (311146-09331-80-2025) Regj. Them, datë 20.02.2026, ka vendosur: “Pezullimin e gjykimit të çështjes administrative, deri në përfundim me vendim gjyqësor të formës së prerë të çështjes administrative, me objekt: “Shfuqizimin e vendimit nr. 5, datë 16 Shtator 2024, të nxjerrë nga Komisioni i Disiplinës, Shkolla e Magjistraturës, përkundrejt palës paditëse O.V””.

Për këtë arsye Komisioneri me shkresën nr. 1260/2, datë 15.07.2026 kërkoj nga ankuesi kopje të kërkesë padisë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe kopje të vendimin Nr. 11103/6205 (311146-09331-80-2025) Regj. Them, datë 20.02.2026 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ankuesi me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 1260/3, datë 24.07.2026 dërgoi dokumentacionin e kërkuar.

Gjatë shqyrtimit paraprak që Komisioneri i ka bërë parashtrimeve dhe dokumentacionit të depozituar nga pala ankuese, ka rezultuar se:

Ankuesi me Kërkesë Padinë datë 29.10.2025 drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë ka kërkuar (Objekti):

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë nga pala e paditur, Shkolla e Magjistraturës, në trajtimin disiplinor të palës paditëse në cilësinë e kandidatit për magjistrat, krahasuar me 51 kandidatë të tjerë, të ndodhur në kushte të njëjta faktike dhe ligjore, të cilët janë konstatuar në shkelje të rregullave të provimit përfundimtar të vitit të dytë të zhvilluar me datë 30 Qershor dhe 1 Korrik 2024.
2. Detyrimin e palës së paditur, Shkolla e Magjistraturës për shpërblim dëmi jo-pasuror shkaktuar palës paditëse O.V, për shkak diskriminimi të drejtpërdrejtë, duke realizuar trajtim të diferencuar të kandidatëve për magjistratë, të ndodhur në kushte të njëjta faktike dhe ligjore.
3. Detyrimin e palës së paditur që të publikojë vendimin e gjykatës, në faqen zyrtare të institucionit publik.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, në seancën përgatitore, me vendimin Nr. 11103/6205 (311146-09331-80-2025) Regj. Them, datë 20.02.2026, ka vendosur: *“Pezullimin e gjykimit të çështjes, derisa të zgjidhet me vendim përfundimtar të formës së prerë çështja administrative, e regjistruar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. 10274/5387 (31154-08037-80-2024), për të cilën ka disponuar me vendimin nr. 3706 (80-2025-3752), datë 28.10.2025”.*

Bazuar në dokumentacionin e depozituar nga pala ankuese në këtë proces, Komisioneri vëren se pretendimi i ngritur nga subjekti ankues për diskriminim nga ana e Shkollës së Magjistraturës, është bërë objekt i shqyrtimit gjyqësor.

Theksojmë se, të njëjtat fakte dhe rrethana janë paraqitur edhe përpara Komisionerit.

Neni 33, pika 7/4, e ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, parashikon se: *“Kur Komisioneri vihet në dijeni se ankuesi ka paraqitur kërkesë padi në gjykatë me objekt konstatim diskriminimi, ndërkohë që ka paraqitur të njëjtën ankesë pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe çështja është në shqyrtim e sipër, Komisioneri merr vendim për pushimin e çështjes”.*

Në këtë kontekst, në kushtet që kjo çështje është duke u gjykuar nga Gjykata, bazuar në sa më sipër, si dhe në paragrafin 3, të nenit 36, të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se: *“...Asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata...”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk mund të shprehet,

lidhur me ankesën me nr. 167 Regj., datë 08.07.2026, të z. O.V, dhe deklaroi pushimin e shqyrtimit të saj¹.

Bazuar në nenin 36, pika 4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar, ku parashikohet shprehimisht se: *“Gjykata mund t’i kërkojë Komisionerit, në çdo fazë të procedimit, që të paraqesë një mendim me shkrim, rezultatet e hetimit të tij, në qoftë se është bërë hetimi, ose çdo informacion tjetër që ka rëndësi për çështjen”*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në rastin kur Gjykata e kërkon atë², përgatit dhe paraqet mendimin me shkrim, lidhur me çështjen sa më sipër.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 36 të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996 *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, i ndryshuar, si dhe referuar nenit 32, pika 1, shkronja a), nenit 33, pika 7/4, dhe nenit 36/4, të ligjit nr. 10221/2010 *“Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”*, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr. 167, datë 08.07.2026, të paraqitur nga subjekti ankues, O.V, për shkak se çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Genta TAFA (BUNGO)

¹ Për analogji shih vendimet me: nr. 141, datë 28.05.2026, nr. 166, datë 12.06.2026 dhe nr. 201, datë 21.07.2026 të Komisionerit.

² Ose me kërkesë drejtuar Gjykatës, të palës së interesuar në procesin gjyqësor të iniciuar.